



**KONTROLLI I LARTË I SHTETIT**  
**Raport Përfundimtar për Auditimin e ushtruar në**  
**“AVOKATURËN E SHTETIT”**

**“MBI PËRPUTHSHMËRINË”**

*Tematik*

<b>Nr.</b>	<b>Emërtimi</b>	<b>Faqe</b>
<b>I</b>	<b>PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE</b>	<b>2-2</b>
<b>II</b>	<b>HYRJA</b>	<b>2-5</b>
<i>a.</i>	Qëllimi dhe Objektivat	2-3
<i>b.</i>	Identifikimi i çështjes	3-3
<i>c.</i>	Përgjegjësitë e strukturave drejtuese	3-3
<i>d.</i>	Përgjegjësitë e audituesve	3-4
<i>e.</i>	Kriteret e vlerësimit	4-4
<i>f.</i>	Standardet e auditimit	4-5
<b>III</b>	<b>PËRSHKRIMI I AUDITIMIT</b>	<b>5-9</b>
	<i>Drejtimi 1: “Ecuria e detyrimeve shtetërore për Vendime të formës së prerë të GJEDNJ dhe Arbitrazhit Ndërkombëtar si dhe vlerat e ekspozimit të Buxhetit të Shtetit nga çështjet në proces gjykimi.”</i>	
<b>IV</b>	<b>KONKLuzioni I AUDITIMIT</b>	<b>9-11</b>
<b>V</b>	<b>ANEKSE</b>	<b>12-17</b>



# KONTROLI I LARTË I SHTETIT

## Raport Përfundimtar për Auditimin e ushtruar në “AVOKATURËN E SHTETIT”

### I- PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE

#### a. Një përshkrim i shkurtër i Auditimit

Mbështetur në Ligjin nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “Për Organizimin dhe Funksonimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”, Kontrolli i Lartë i Shtetit auditoi “Avokaturën e Shtetit”, më poshtë ASH, për periudhën 01.01.2018 deri më 31.08.2019 me objekt “Auditim tematik përputhshmërie”, lidhur me “Ecurinë e detyrimeve shtetërore për Vendime të formës së prerë të GJEDNJ dhe Arbitrazhit Ndërkombëtar si dhe vlerat e ekspozimit të Buxhetit të Shtetit nga çështjet në proces gjykimi”. Në këtë auditim u angazhuan 2 (dy) auditues të Kontrollit të Lartë të Shtetit. Auditimi u krye nga data 06.09.2019 deri më 25.09.2019 dhe u përqëndrua në drejtimin e përcaktuar në programin e auditimit nr. 632/2 prot. datë 06.09.2019. Konkluzionet përkatëse paraqiten në mënyrë më të hollësishme në pjesën e IV të këtij Raporti Përfundimtar dhe konsistojnë kryesisht në; mungesën e një baze të plotë të dhënash për vendimet e formës së prerë të gjykatave të Arbitrazhit Ndërkombëtar të njohura nga gjykatat shqiptare si dhe vlerat financiare të ekzekutuara prej tyre, megjithatë institucioni vijonte punën për plotësimin e regjistrit të posaçëm fizik dhe elektronik të çështjeve të trajtuara apo në trajtim të gjykatave të huaja, ndërkombëtare dhe arbitrazhit ndërkombëtar.

Në përfundim të procedurës audituese, akt-konstatimit, Projekt Raportit të mbajtur, shkresës së ASH, nr. 632/4 prot. datë 21.10.2019, u hartua Raporti Përfundimtar i Auditimit.

### II- HYRJA

Mbështetur në Ligjin nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “Mbi Organizimin dhe Funksonimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”, Kontrolli i Lartë i Shtetit auditoi “Avokaturën e Shtetit”, më poshtë e emërtuar “ASH”, në bazë të programit të auditimit tematik të miratuar nga Kryetari i Kontrollit të Lartë të Shtetit me nr.632/2 prot. datë 06.09.2019, për periudhën e auditimit nga data 01.01.2018 deri në 31.08.2019, me afat auditimi nga data 06.09.2019 deri më 25.09.2019, dhe lloj auditimi “Auditim Përputhshmërie” i cili u krye nga grupi i auditimit me përbërje:

1. K.....X.... (Përgjegjës grupi)
2. F.....Z.....

#### Qëllimi i auditimit:

Qëllimi i auditimit është, dhënia e një vlerësimi objektiv, profesional, e të pavarur, mbi shkallën e ndjekjes nga subjekti i audituar të ligjeve dhe rregulloreve, politikave, kodeve të vendosura apo termave dhe kushteve mbi të cilat është rënë dakord, mbi bazën e të cilave ushtron veprimtarinë “Avokatura e Shtetit”. Vlerësimin e përputhshmërisë së veprimeve procedurale e administrative, të kryera me kriteret dhe kërkesat e legjisllacionit. Evidentimi i shkeljeve të parimeve të ligjshmërisë dhe menaxhimit të shëndoshë financiar, shfrytëzimin me efikasitet, efektivitet dhe ekonomikitet të pasurisë shtetërore dhe fondeve publike, si dhe dhënia e rekomandimeve përkatëse për përmirësimin e gjendjes në vijim. Raportimin e të gjitha çështjeve të tjera që dalin apo lidhen me auditimin, të cilat Kontrolli i Lartë i Shtetit i konsideron të rëndësishme për t’u bërë publike.



## **KONTROLLI I LARTË I SHETIT**

### **Raport Përfundimtar për Auditimin e ushtruar në “AVOKATURËN E SHETIT”**

#### **Objektivat e auditimit:**

Objektivat specifike të auditimit ose pohimet për marrjen e garancive për besueshmërinë e sistemeve të ngritura, procedurave të ndjekura nga “Avokatura e Shtetit”, gjatë procesit të realizimit të objektivave në përputhje me kuadrin ligjor në fuqi. Vlerësimi i saktësisë së informacioneve në aspektet materiale në përputhje me kuadrin ligjor e rregullator, nëse janë zbatuar parimet e profesionalizmit, të efikasitetit, dhe sjelljes së zyrtarëve të sektorit publik.

#### **Identifikimi i çështjes:**

Fushëveprimi i këtij auditimi është vlerësimi me siguri të arsyeshme i veprimtarisë së “Avokatura e Shtetit”, për periudhën objekt auditimi nga 01.01.2018 deri më 31.08.2019, në përputhje me aktet ligjore të cilat rregullojnë veprimtarinë e këtij institucioni dhe konkretisht:  
-Përfaqësimi dhe mbrojtja e interesave të shtetit shqiptar pranë gjykatave të huaja dhe organizmave ndërkombëtarë, GJEDNJ dhe Arbitrazhit Ndërkombëtar si dhe vlerat e ekspozimit të Buxhetit të Shtetit nga këto çështje.

#### **Përgjegjësia e Drejtimit për Përputhshmërinë me legjislacionin në fuqi:**

Është detyrimi i menaxherëve të njësive, që, në kryerjen e veprimtarive, të respektojnë parimet e profesionalizmit, të efikasitetit, të konfidencialitetit, të përgjegjësisë dhe korrektësisë në zbatimin e legjislacionit në fuqi., si dhe të përgjigjen për veprimet e tyre dhe rezultatet që burojnë prej tyre përpara organit që i ka emëruar ata ose të cilëve u ka deleguar përgjegjësinë sipas përcaktimeve në Ligjin Nr.10 018, datë 13.11.2008, i ndryshuar.

#### **Përgjegjësia e Audituesit të KLSH për auditimin e Përputhshmërisë**

Përgjegjësia jonë (*Audituesit e KLSH-së*) është që nëpërmjet auditimit të realizuar;

-Të vlerësojë nëse, informacionet mbi çështjet në të gjitha aspektet materiale janë në përputhje me kriteret e përcaktuara sipas legjislacionit në fuqi. Masa e ndjekjes nga subjekti i audituar i rregullave, legjislacionit dhe akteve normative, politikave, kodeve të miratuara apo kushtet e përcaktuara (*ISSAI 4000*), nuk paraqesin devijime materiale nga kriteret e vlerësimit, si pasaktësi apo gabime dhe janë në përputhje me kuadrin rregullator mbi bazën e të cilit e ushtrohet veprimtaria e subjektit të audituar. Auditimi është kryer në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit (*INTOSAI*), bazuar në këto standarde ne aplikojmë gjykimin dhe skepticizmin tonë profesional në punën audituese.

-Të kryejë në mënyrë efektive auditimin (*ISSAI 1300*)

-Të vlerësojë nëse është siguruar evidenca e mjaftueshme dhe e përshtatshme e auditimit dhe nëse bazuar në këtë evidence ai mund të formojë konkluzionet përkatëse. (*ISSAI 1500/ISA 300*).

-Të kryejë procedura të përshtatshme auditimi në funksion të këtij objekti.

Ne jemi të pavarur kundrejt subjektit të audituar, e theksuar kjo në *ISSAI*-n 10 “Deklarata e Meksikës mbi Pavarësinë e SAI-t”, si dhe *ISSAI* 30 “Kodi Etik”, apo edhe çështje të tjera që lidhen me auditimin. Ne i kemi përmbushur përgjegjësitë tona etike, në përputhje me standardet e sipërpërmendura. Gjithashtu, ne besojmë se dëshmitë e mara gjatë punës sonë audituese janë të mjaftueshme dhe të përshtatshme për të vlerësuar përputhshmërinë e aktivitetit. Objektivat e punës sonë lidhen me garantimin e sigurisë së arsyeshme nëse çështjet subjekt auditimi, që mund të kenë ekzistuar, si dhe për të konkluduar me një raport auditimi. Siguria e arsyeshme është një nivel i lartë sigurie, por nuk garanton që auditimi i kryer në përputhje me standardet mundëson identifikimin e çdo gabimi apo anomalie që mund të ekzistojë në veprimtarinë e subjektit të audituar.



## KONTROLLI I LARTË I SHETIT

### Raport Përfundimtar për Auditimin e ushtruar në “AVOKATURËN E SHETIT”

#### **Dokumentimi i rezultateve të auditimit:**

Nga audituesit u përgatit dokumentacioni i auditimit, i mjaftueshëm për të mundësuar dhe kuptuar natyrën, kohën, dhe shtrirjen e procedurave të auditimit të kryera në përputhje me standardet përkatëse dhe kërkesat e zbatueshme ligjore dhe rregullatore. Në përfundim të auditimit në terren mbi bazën e evidencave të marra gjatë auditimit, dhe akt-konstatimit të mbajtur u përgatit Projekt Raporti i Auditimit.

#### **Kriteret e vlerësimit:**

-Ligji nr.10018 datë 13.11.2008 “Për Avokaturën e Shtetit” ndryshuar me Ligjin nr. 86/2018 datë 22.11.2018.

-VKM nr.392, datë 08.04.2009 Për Miratimin e Rregullores “Për Marrëdhëniet e Avokaturës së Shtetit me Institucionet Shtetërore dhe Entet Publike, Rolin e Avokatëve të Shtetit në Gjykim, si dhe Normat e Posaçme Procedurale”.

-Rregullore e Brendshme për Organizimin dhe Funksonimin e Avokaturës së Shtetit miratuar me Urdhrin nr. 68 datë 28.03.2019 të Avokatit të Përgjithshëm të Shtetit.

-Akte të tjera ligjore dhe nënligjore të detyrueshëm për zbatim.

#### **Standardet e Auditimit**

Auditimi u bazua në:

-Ligjin nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”, Manualin e Auditimit të Përputhshmërisë, Rregulloren “Për Procedurat e Auditimit” miratuar me Vendimin e Kryetarit të KLSH-së Nr. 107 datë 08.09.2017, i ndryshuar, referenca të tjera ligjore dhe në kërkesat e Standardeve Ndërkombëtare të Auditimit si:

-Manuali i Auditimit të Përputhshmërisë. Referencë në Standardet Ndërkombëtare të Auditimit (ISSAI) të INTOSAI-t dhe Standardet Ndërkombëtare të Auditimit (SNA) të Federatës Ndërkombëtare të Kontabilistëve IFAC.

#### **Materialiteti dhe metodologjia e bazuar në risk**

Kontrolli i Lartë i Shtetit konsideron një nivel sasior materialiteti deri në 2% në nivel grupi dhe llogarie. Në disa raste, gabimi edhe pse jo material nga ana sasiore, mund të shfaqet materiale nga *ana cilësore* “Një çështje ose grup çështjesh mund të jenë materiale ose për shkak të sasisë, natyrës (karakteristikave të brendshme) ose në varësi të kontekstit të tyre” për vet impaktin real por dhe ndjeshmërinë publike që ka veprimtaria e institucionit. Çështjet që janë materiale nga natyra ose përmbajtja duhet të zbulohen; ato do të lidhen me përputhmërinë e veprimtarisë së institucionit, duke u përfshirë kështu në konkluzionet e auditimit. Megjithatë, mbetet në gjykimin e KLSH-së, që çështje të veçanta në varësi të rëndësisë dhe impaktit të tyre, të merren në konsideratë në raportin e auditimit.

#### **Praktikat e ndjekura në kryerjen e auditimit**

Metodat dhe teknikat e kontrollit të përdorura nga audituesit gjatë auditimit u bazuan kryesisht në metodologjinë e aplikuar gjatë fazës së planifikimit;

-Raporte dhe informacione nga shfrytëzimi i raporteve/ informacioneve që lidhen direkt me objektivat e auditimit të marra në formë elektronike dhe shkresore.

-Intervistimi i personelit që ka patur role specifike

Objektivi i audituesve ishte identifikimi dhe vlerësimi i risqeve e anomalive materiale në nivelin e pohimeve, nëpërmjet të kuptuarit e njësisë dhe mjedisit të saj, duke përfshirë



## KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

### Raport Përfundimtar për Auditimin e ushtruar në “AVOKATURËN E SHTETIT”

kontrollin e brendshëm të njësisë dhe duke krijuar kështu bazën për hartimin dhe implementimin e përgjigjeve kundrejt risqeve të vlerësuara drejt anomalive materiale.

## II- PËRSHKRIMI I AUDITIMIT

Avokatura e Shtetit është person juridik publik, në varësi të Kryeministrit që ka për mision eskuzivitetin e dhënies së asistencës juridike, i cili përfshin shërbimin këshillimor dhe të **përfaqësimit për personat juridik shtetëror**. Ajo drejtohet nga Avokati i Përgjithshëm i Shtetit dhe organizohet në dy nivele, në nivel qendror dhe vendor. Në nivel qendror përbëhet nga: a) zyra e përfaqësimit ligjor në gjykatat kombëtare; b) zyra e këshillimit dhe koordinimit ndërministror; c) **zyra e përfaqësimit në gjykatat e huaja, ndërkombëtare dhe në arbitrazhin ndërkombëtar**; ç) zyra e inspektimit; d) Kolegji i Avokaturës së Shtetit. Detyrat dhe funksionet parashikohen e të cilave parashikohen në rregulloren e brendshme të institucionit. Ndër funksionet bazë të institucionit janë **mbrojtja e interesave pasurorë të shtetit shqiptar pranë gjykatave kombëtare, ndërkombëtare dhe të huaja**, ku Republika e Shqipërisë është palë. Këtu përmendim Gjykatën Europiane për të Drejtat e Njeriut (në vijim “GJEDNJ”) dhe “Arbitrazhin Ndërkombëtar”.

✦ **Drejtimi 1: “Ecuria e detyrimeve shtetërore për Vendime të formës së prerë të GJEDNJ dhe Arbitrazhit Ndërkombëtar si dhe vlerat e ekspozimit të Buxhetit të Shtetit nga çështjet në proces gjykim”.**

- *Mbi çështjet e shqyrtuara në Gjykatën Europiane për të Drejtat e Njeriut (GJEDNJ)*

Ligji nr.10018 datë 13.11.2008 “Për Avokaturën e Shtetit”, i ndryshuar në nenin 9 të tij përcakton se, Avokatura e Shtetit përfaqëson mbrojtjen e interesave të shtetit shqiptar pranë gjykatave të huaja dhe organizmave ndërkombëtarë, të cilat kryhen nëpërmjet zyrës përkatëse të përfaqësimit në gjykatat e huaja, ndërkombëtare dhe në arbitrazhin. Detyrat e kësaj zyre, përcaktohen në rregulloren e brendshme të funksionimit të Avokaturës së Shtetit. Në nenin 19/1 ligji përcakton se, **Vendimet e formës së prerë të Gjykatës Europiane për të Drejtat e Njeriut (në vijim “GJEDNJ”)**, për çdo çështje ku Republika e Shqipërisë është palë, **janë të detyrueshme për zbatim** dhe ekzekutohen sipas procedurës së parashikuar në ligj. Konkretisht në nenet 19/2 deri 19/6 të tij përshkruhen veprimet të cilat ndërmerren nga Avokatura e Shtetit dhe institucionet përgjegjëse për zbatimin e këtyre vendimeve dhe afatet përkatëse. Referuar nenit 17 të rregullores së brendshme të institucionit, pranë zyrës së përfaqësimit krijohet, administrohet dhe përditësohet regjistri i posaçëm fizik dhe elektronik i çështjeve të trajtuara apo në trajtim të gjykatave të huaja, ndërkombëtare dhe arbitrazhit ndërkombëtar, i cili do të plotësohet nga juristi i Zyrës i ngarkuar me këtë qëllim me urdhër të Avokatit të Përgjithshëm të Shtetit. Referuar këtyre dispozitave me Urdhrin nr. 259 datë 01.07.2019 Avokati i Përgjithshëm ka përcaktuar dhe personelin përgjegjës për plotësimin e tij. Deri në këtë fazë të auditimit ky regjistër nuk është përfunduar.

Sipas informacionit të administruar rezultoi sepër periudhën objekt auditimi vendimmarrjet e GJEDNJ paraqiten:

- Për periudhën Viti 2018, GJEDNJ ka dalë me tre vendime përfundimtare kundër Shqipërisë duke akorduar shpërblim dëmi në vlerën **13,452,860 euro** nga të cilat janë ekzekutuar vetëm 4,703, euro, tabela në vijim.



## KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

### Raport Përfundimtar për Auditimin e ushtruar në “AVOKATURËN E SHTETIT”

Viti	Vendimi	Pretendimi	Lloji	Data e vendimit	Dispozitivi / Vlera ne Euro		Ekzekutimi ne Euro	Data e ekzekutimit
2018	31959/13 [redacted] Albania	neni 3 i Konventes	Penale	20.11.2018	shkelje	0	0	
2018	48717/08 [redacted] v. Albania	Neni 6/1 i Konventës	Penale	25.09.2018	shkelje	0	0	
2018	47403/15 [redacted] Albania	neni 5/1 i Konventes	Penale	18.09.2018	Nuk ka pasur shkelje	0	0	
2018	14816/08 [redacted] Albania	Neni 6 i Konventës	Penale	22/05/2018	shkelje	1,000	1,022	30.04.2019
2018	57456/11 [redacted] v. Albania	Neni 6/1 i Konventës	Penale	22/05/2018	shkelje	0	0	
2018	72359/11 [redacted] v. Albania	Neni 6/1 si dhe 3 (c) (d) i Konventës	Penale		shkelje	0	0	
2018	383 49/05 [redacted] v. Albania	Neni 6 i Konventës	Civile	26.20.08	shkelje	0	0	
2018	43928/13 [redacted] v. Albania	shkelje te nenit 8	Civile	10/4/2018	Papranueshmeri	0	0	
	43934/13 [redacted] Albania	shkelje te nenit 8	Civile		Papranueshmeri			
	44107/13 [redacted] v. Albania	shkelje te nenit 8	Civile		Papranueshmeri			
	44132/13 [redacted] v. Albania	shkelje te nenit 8	Civile		Papranueshmeri			
	44136/13 [redacted] v. Albania	shkelje te nenit 8	Civile		Papranueshmeri			
	44140/13 [redacted] v. Albania	shkelje te nenit 8	Civile		Papranueshmeri			
	44147/13 [redacted] v. Albania	shkelje te nenit 8	Civile		Papranueshmeri			
	44150/13 [redacted] v. Albania	shkelje te nenit 8	Civile		Papranueshmeri			
	44152/13 [redacted] and [redacted] v. Albania	shkelje te nenit 8	Civile		Papranueshmeri			
	44153/13 [redacted] v. Albania	shkelje te nenit 8	Civile		Papranueshmeri			
	44522/13 [redacted] v. Albania	shkelje te nenit 8	Civile		Papranueshmeri			
	44526/13 [redacted] v. Albania	shkelje te nenit 8	Civile		Papranueshmeri			
	44535/13 [redacted] v. Albania	shkelje te nenit 8	Civile		Papranueshmeri			
	44542/13 [redacted] and [redacted] Albania	shkelje te nenit 8	Civile		Papranueshmeri			
44548/13 [redacted] v. Albania	shkelje te nenit 8	Civile	Papranueshmeri					
44611/13 [redacted] v. Albania	shkelje te nenit 8	Civile	Papranueshmeri					
44632/13 [redacted] v. Albania	shkelje te nenit 8	Civile	Papranueshmeri					
2018	74389/13 [redacted] v. Albania	Shkelje te nenit 3	Penale	13.02.2018	shkelje	4,560	4,703	30.04.2019
2018	10613/16 [redacted] and others v. Albania	Shkelja te nenit 6, 13 dhe 1 te protokollit 1	Civile	11.01.2018	shkelje	13,447,300	Dërguar MD	Në proces
<b>Gjithsej</b>						<b>13,452,860</b>	<b>4,703</b>	

Burimi: ASH, përpunuar nga grupi i auditimit

-Për periudhën Janar-Gusht 2019, GJEDNJ ka dalë me katër vendime përfundimtare nga të cilët, në dy raste janë rrëzuar pretendimet e palës paditëse dhe dy vendime janë marrë kundër Shqipërisë, duke akorduar shpërblim dëmi në vlerën **117,050 euro**. Nga këto është ekzekutuar plotësisht një vendim dhe ka mbetur i paekzekutuar vendimi me vlerën 13,450 euro, tabela më poshtë.

Viti	Vendimi	Pretendimi	Lloji	Data e vendimit	Dispozitivi / Vlera ne Euro		Ekzekutimi ne Euro	Data e ekzekutimit
2019	80544/12 [redacted] v. Albania	shkelje e nenit 6/1	Penale	02.04.2019	nuk ka pasur shkelje	0	0	
2019	54091/13 [redacted] v. Albania	shkelje te nenit 6/1,3/c	Penale	02.04.2019	nuk ka pasur shkelje	0	0	
2019	62907/16 [redacted] v. Albania	Neni 2 dhe neni 2/1 i Konventes	Penale	05.03.2019	shkelje Marreveshje Miqesore	103,600	104,237	13.08.2019
2019	29309/16 [redacted] v. Albania	Neni 2/1 dhe neni 3 i Konventës	Penale	11.06.2019	shkelje	13,450	Përfundimtar në datën 11 Shtator 2019	në proces
<b>Gjithsej</b>						<b>117,050</b>	<b>104,237</b>	

Burimi: ASH, përpunuar nga grupi i auditimit



## KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

### Raport Përfundimtar për Auditimin e ushtruar në “AVOKATURËN E SHTETIT”

Sa i përket vendimeve të GJEDNJ të mbartura nga viti 2017 dhe të ekzekutuara nga shteti shqiptar për periudhën nën auditim, Janar 2018-Gusht 2019 evidentohen gjithsej 6 vendime të ekzekutuara me një vlerë financiare prej 26,923 euro, tabela më poshtë:

Nr.	Vendimi	Pretendimi	Lloji	Data e vendimit	Dispozitivi / Vlera ne Euro		Ekzekutimi ne Euro	Data e ekzekutimit
1	5250/07 [redacted] v. Albania	Nenet 6, 13 & neni 1 Prot.1 të Konventës	Civile	03.03.2016	Shkelje	7,850	8,316	23.01.2018
2	23136/13 [redacted] v. Albania	Shkelje te neni 6/1 te Konventes	Civile	24.01.2017	Marrëveshje Miqësore	1,800	1,868	11.07.2018
3	53103/15 [redacted] v. Albania	Shkelje te neni 6/1 te Konventes	Civile	24.01.2017	Marrëveshje Miqësore	1,000	1,000	11.07.2018
4	32913/03 [redacted] K. Shqipërisë".	Nenet 6.1 si dhe neni 1 i Protokollit 1 të Konventës	Civile	21.04.2016	Shkelje vetëm 6/1 dhe 13	1,000	1,068	23.01.2018
5	74941/4 [redacted] k.Shqipërisë"	Nenet 6.1 i Konventës	Civile	16.02.2017	Marrëveshje Miqësore	10,400	11,139	05.07.2019
6	57063/14 [redacted] k.Shqipërisë"	Nenet 6.1 i Konventës	Civile	16.02.2017	Shkelje	3,300	3,532	27.06.2019
<b>Gjithsej</b>						<b>25,350</b>	<b>26,923</b>	

*Burimi: ASH, përpunuar nga grupi i auditimit*

Gjendja e vendimeve gjyqësore të paekzekutuar ose në proces më datë 31.08.2019 për të cilën ekspozohet buxheti i shtetit paraqitet si më poshtë:

Viti	Vendimi	Pretendimi	Lloji	Data e vendimit	Dispozitivi / Vlera ne Euro		Ekzekutimi ne Euro	Data e ekzekutimit
2019	29309/16 [redacted] v. Albania	Neni 2/1 dhe neni 3 i Konventës	Penale	11.06.2019	shkelje	13,450	Përfundimtar në datën 11 Shtator	Në proces
2018	10613/16 [redacted] and others v. Albania	Shkelja te neni 6, 13 dhe 1 te Protokollit 1	Civile	11.01.2018	shkelje	13,447,300	Dërguar MĐ	Në proces
2016	48522/10 [redacted] dhe [redacted] v. Albania	Shkelje e neni 6/1, 13, neni 1 Protokollit nr. 1 i Konventës	Civile	17.03.2016	Shkelje	4,417,750	Ka dalë VKM	Në proces
2015	6858/11 [redacted] v. Albania	Shkelje e neni 5/1, dhe 5/4 i Konventës	Penale	14.09.2015	Shkelje	15,600	Dërguar MD/KM	Në proces
<b>Gjithsej</b>						<b>17,894,100</b>	<b>0</b>	

*Burimi: ASH, përpunuar nga grupi i auditimit*

Pra në total deri më date 31.08.2019 evidentohen katër vendime të GJEDNJ të paekzekutuara të dhëna ndërmjet viteve 2015-2019, me një vlerë financiare prej **17,894,100 euro** e cila për shkak të aplikimit të interesave në rast vonesash në pagesë ka tendencë në rritje.

*Theksojmë se, përsa i takon ekzekutimit të vendimeve të GJEDNJ-së, me ndryshimet ligjore të në ligjin 10018/2008 “Për Avokaturën e Shtetit” të cilat kanë hyrë në fuqi më datë 29.12.2018, janë përcaktuar hapat dhe afatet e institucioneve respektive lidhur me ekzekutimin e vendimit të cilat përpara këtyre ndryshimeve nuk parashikoheshin me ndonjë akt tjetër ligjor.*



## KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

### Raport Përfundimtar për Auditimin e ushtruar në “AVOKATURËN E SHTETIT”

- *Mbi çështjet e shqyrtuara në Arbitrazhin Ndërkombëtar*

Sipas legjislacionit shqiptar dhe konkretisht Kodit të Procedurës Civile nenet 393 deri 399 përcaktojnë njohjen e vendimeve të gjykatave të huaja përfshirë këtu njohjen e vendimit përfundimtar të një arbitrazhi ndërkombëtar, Konventën e New Yorkut për njohjen dhe zbatimin e vendimeve të huaja të arbitrazhit, Kodit të Procedurës Civile, Vendimi Unifikues i Gjykatës së Lartë nr. 6/2011. Në këto akte parashikohen:

- a. kërkesat formal-procedurale që duhet të ndiqen nga pala kërkuese për të depozituar kërkesën për njohje dhe dhënie fuqie juridike të vendimeve të gjykatave të huaja (dhe atyre të arbitrazhit);
- b. rastet kur njohja dhe dhënia fuqi juridike refuzohet;
- c. investimi i Gjykatës së Apelit si gjykatë e shkallës së parë për njohje dhe dhënie fuqie juridike të vendimeve të gjykatave të huaja (dhe atyre të arbitrazhit);

Në bazë dhe reference të nenit 79/a të KPC gjykata e Apelit është e detyruar të thërrasë në këto lloj gjykimesh Avokaturën e Shtetit krahas institucionit të interesuar, edhe pse në praktikë ka rezultuar që ky detyrim nuk përmbushet në çdo rast.

Në vijim me ndryshimet e vitit 2018, në ligjin 10018/2008 “Për Avokaturën e Shtetit” parashikohet se, në rast arbitrazhi ndërkombëtar në fushën e investimeve, ku palë është Republika e Shqipërisë, organi i interesuar sipas këtij ligji, konsiderohet ministria përgjegjëse, e cila mbulon shpenzimet e nevojshme për përfaqësimin dhe mbrojtjen e interesave të Republikës së Shqipërisë. Kur kjo nuk mund të identifikohet, organi i interesuar konsiderohet ministria përgjegjëse për investimet e huaja.

*Theksojmë se, ndryshe nga vendimet e GJEDNJ, vendimet e arbitrazhit ndërkombëtar bëhen të zbatueshëm pas njohjes së vendimit nga Gjykata Shqiptare e Apelit. Për vendimet e zbatueshme Avokatura e Shtetit nuk disponon informacion lidhur me shumat e paguara nga institucionet respektive palë në gjykim, e si e tillë vlera e ekzekutuar dhe ajo për tu ekzekutuar nga buxheti i shtetit nuk mund të konfirmohet nga ky institucion, çka në vlerësimin tonë paraqet nevojën për një qasje ndryshe në dispozitat ligjore lidhur me këtë çështje.*

Sipas të dhënave të dhënave paraqitura prej Avokaturës së Shtetit, prej vitit 2011 evidentohen 10 vendime të fromës së prerë të dhënë nga arbitrazhi ndërkombëtar (Aneksi II) bashkëlidhur, nga të cilët;

-*Tre vendime janë dhënë në favor të Shqipërisë në shumën 8,168,523 euro për të cilët nuk ka përfunduar ende ekzekutimi i shumave përkatëse megjithëse datojnë prej vitit 2013.*

-*Dy vendime vendime janë rrëzuar pretendimet e palës kërkuese.*

-*Pesë vendime vendime janë dhënë në disfavor të Shqipërisë në vlerën 5,188,087 euro nga të cilat 3 (tre) vendime në shumën e detyrimit 4,230,180 euro janë njohur nga gjykata dhe janë të zbatueshëm megjithëse është bërë rekurs në Gjykatën e Lartë nga institucioni përkatës apo ASH, 1(një) vendim nuk është njohur nga gjykata e apelit dhe për 1(një) vendim ASH nuk disponon informacion për njohje nga gjykata. Këto vendime kundër i përkasin periudhave viti 2015 dhe 2016.*

Aktualisht sipas të dhënave të Avokaturës së Shtetit, evidentohen 9 (nëntë) çështje gjyqësore, në proces pa vendim përfundimtar (Aneksi III) bashkëlidhur:

-Në çështjen “H..... SRL vs Ministry of Infrastructure & Energy” zhvilluar pranë ICC - Dhoma Ndërkombëtare e Tregtisë është përfunduar gjykimi në themel, **në favor të Shqipërisë** duke rrëzuar pretendimet e Padiësit dhe ngarkuar këtë të fundit me rimbursimin e





## KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

### Raport Përfundimtar për Auditimin e ushtruar në “AVOKATURËN E SHTETIT”

kostove të Shqipërisë në vlerën 733,075 euro por vendimi konsiderohet jopërfundimtar, pasi Paditësi i ka kërkuar Tribunalit rishikim të vendimit.

-Në çështjen “H.... SRL, C....SRL, F. B...., M...R...., S... Gr..., L... C... vs Albania”, zhvilluar pranë ICSID - Qendra Ndërkombëtare për Zgjidhjen e Mosmarrëveshjeve të Investimit **ka dënuar Shqipërinë** me vlerën **110,000,000 euro**, Shqipëria ka aplikuar për anulim të vendimit dhe Gjykata e ka pranuar aplikimin. Në përfundim vendimi bëhet i ekzekutueshëm pas njohjes nga Gjykata Shqiptare e Apelit.

- 3 (tre) çështje ndodhen në faze pritje të vendimit.

- 4 (katër) çështje ndodhen në proces.

### III- KONKLUZIONE

Nga auditimi i kryer pranë “Avokaturës së Shtetit” lidhur me, ecurinë e detyrimeve nga vendimet e GJEDNJ dhe Arbitrazhit Ndërkombëtar ku shteti shqiptar është palë rezultoi se:

-Nga ana e Avokaturës së Shtetit janë ndërmarrë hapa administrativë për përditësimin e regjistrit të posaçëm fizik dhe elektronik i çështjeve, të trajtuara apo në trajtim të gjykatave të huaja, ndërkombëtare dhe arbitrazhit ndërkombëtar, megjithatë inkurajohet përsheptimi i punës për përmbylljen sa më parë të tij.

-Për 4 Vendime të GJEDNJ të paekzekutuara prej shtetit shqiptar deri më datë 31.08.2019 në vlerën 17,894,100 euro, Avokatura e Shtetit, pavarësisht veprimeve procedural dhe përcjelljes së vendimeve drejt hallkave të tjera institucionale, nevojitet të ndjekë me vëmendje të posaçme ecurinë e ekzekutimit të tyre referuar dhe përcaktimeve të reja ligjore në ligjit organik konkretisht nenit 19/1 deri 19/10 të tij, si dhe duke informuar Këshillin e Ministrave në rastet e vështirësive të hasura në zbatimin e tyre.

-Sa i përket vendimeve të Arbitrazhit Ndërkombëtar rezultoi se, ASH nuk disponon një bazë të plotë dhe të pakotenstueshme të dhënash për këto vendime të cilat më pas duhet të njihen nga gjykatat shqiptare si dhe vlerat financiare të ekzekutuara prej tyre, pasi organet shtetërore të cilat janë zbatues të tyre, pas njohjes së vendimit nga gjykatat shqiptare nuk dërgonin informacion të mëtejshëm pranë ASH lidhur ecurinë e ekzekutimit të tyre.

Për përmirësimin e gjendjes rekomandojmë marrjen e masave si **më poshtë**:

#### A. MASA ORGANIZATIVE

**1- Gjetje nga auditimi:** Nga auditimi mbi të dhënat e paraqitur nga Avokatura e Shtetit lidhur me çështjet e gjykuara nga gjykatat ndërkombëtare rezultoi se, ende nuk ka përfunduar regjistri i posaçëm për çështjet ndërkombëtare megjithëse nga ana e institucionit janë ndërmarrë hapa administrativë në këtë drejtim. Për këtë, Avokati i Përgjithshëm me Urdhrin nr. 259 datë 01.07.2019 ka përcaktuar personelin përgjegjës për plotësimin e tij. Sipas rregullores së brendshme të institucionit regjistri është detyruar referuar nenit 17 të saj, ku përcaktohet se, pranë zyrës së përfaqësimit krijohet, administrohet dhe përditësohet regjistri i posaçëm fizik dhe elektronik i çështjeve të trajtuara apo në trajtim të gjykatave të huaja, ndërkombëtare dhe arbitrazhit ndërkombëtar, i cili do të plotësohet nga juristi i Zyrës i ngarkuar me këtë qëllim me urdhër të Avokatit të Përgjithshëm të Shtetit. Lidhur me këtë çështje KLSH në auditimin e mëparshëm pranë këtij institucioni, ka dhënë rekomandimet përkatëse. Sipas të dhënave të disponuara, vendimet e gjykatave ndërkombëtare të dhëna për periudhën nën auditim paraqiten si vijon:



## KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

### Raport Përfundimtar për Auditimin e ushtruar në “AVOKATURËN E SHTETIT”

#### 1.1 Vendime të Gjykatës Europiane për të Drejtat e Njeriut

Sipas informacionit të administruar rezultoi se, për periudhën objekt auditimi ecuria e vendimeve të mëparëshme dhe vendimmarrjet e GJEDNJ paraqiten si vijon:

- *Viti 2018*, GJEDNJ ka dalë me tre vendime përfundimtare kundër Shqipërisë duke akorduar shpërblim dëmi në vlerën **13,452,860 euro** nga të cilat janë ekzekutuar vetëm 4,703 euro.
- *Periudha Janar-Gusht 2019*, GJEDNJ ka dalë me katër vendime përfundimtare, në dy prej të cilëve janë rrëzuar pretendimet e palës paditëse dhe dy vendime janë marrë kundër Shqipërisë, duke akorduar shpërblim dëmi në vlerën **117,050 euro**. Nga dy vendimet kundër është ekzekutuar plotësisht një vendim dhe ka mbetur i paekzekutuar vendimi me vlerën 13,450 euro.

Shteti shqiptar për periudhën, Janar 2018-Gusht 2019 ka ekzekutuar edhe gjashtë vendime të GJEDNJ, të mbartura nga viti 2017 me një vlerë prej **26,923 euro**. Vendimet të mëparshme ende të paekzekutuar paraqiten katër vendime ndërmjet viteve 2015-2019 të cilat kapin një vlerë financiare

prej **17,894,100 euro**, e cila për shkak të aplikimit të interesave në rast vonesash për ekzekutim ka tendencë rritëse.

Me ndryshimet e fundit në ligjin nr.10018 datë 13.11.2008 “Për Avokaturën e Shtetit” të cilat kanë hyrë në fuqi më datë 29.12.2018, janë përcaktuar hapat dhe afatet e institucioneve respektive lidhur me ekzekutimin e vendimeve të GJEDNJ-së të cilat përpara ndryshimeve ligjore nuk parashikoheshin me ndonjë akt ligjor, çka pritet të sjellë përshejtim të veprimeve dhe uljen e kostove shtesë nga moszbatimi në kohë i tyre.

#### 1.2 Vendime të Arbitrazhit Ndërkombëtar

Mbi bazën e të dhënave të administruara rezultoi se, prej vitit 2011 janë dhënë 10 vendime të formës së prerë nga gjykatat e arbitrazhit ndërkombëtar nga të cilët;

- Tre vendime* janë dhënë në favor të Shqipërisë në shumën 8,168,523 euro për të cilët nuk ka përfunduar ende ekzekutimi i shumave përkatëse megjithëse datojnë prej vitit 2011.
- Dy vendime* janë dhënë kundër pretendimeve të palës kërkuese.
- Pesë vendime* janë dhënë në disfavor të Shqipërisë në vlerën **5,188,087 euro** nga të cilat 3 (tre) vendime në shumën e detyrimit 4,230,180 euro janë njohur nga gjykata dhe janë të zbatueshëm megjithëse është bërë rekurs në Gjykatën e Lartë nga institucioni përkatës apo ASH, 1(një) vendim nuk është njohur nga gjykata dhe për 1(një) vendim Avokatura e Shtetit nuk disponon informacion për njohje nga gjykatat shqiptare. Këto vendime kundër i përkasin periudhave 2012,2015 dhe 2016.

Aktualisht evidentohen 9 (nëntë) çështje gjyqësore në proces ende pa vendim përfundimtar, nga të cilat 3(tre) çështje ndodhen në pritje vendimi dhe 4 (katër) çështje ndodhen në proces shqyrtimi ndërsa për dy çështjet e tjera vendimet janë jopërfundimtare ku përmendim.

-Çështja “H..... SRL vs Ministry of Infrastructure & Energy” zhvilluar pranë ICC - Dhoma Ndërkombëtare e Tregtisë është përfunduar gjykimi në themel, **në favor të Shqipërisë** duke rrëzuar pretendimet e Paditësit dhe ngarkuar këtë të fundit me rimbursimin e kostove të Shqipërisë në vlerën 733,075 euro por vendimi konsiderohet jopërfundimtar, pasi Paditësi i ka kërkuar Tribunalit rishikim të Vendimit.



## KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

### Raport Përfundimtar për Auditimin e ushtruar në “AVOKATURËN E SHTETIT”

-Çështja “H.... SRL, C..... SRL, F.... B....., M..... R....., S..... G.... L.... C. vs Albania”, zhvilluar pranë ICSID - Qendra Ndërkombëtare për Zgjidhjen e Mosmarrëveshjeve të Investimit **ka dënuar Shqipërinë** me vlerën **110,000,000 euro**. Shqipëria ka aplikuar për anulim të vendimit dhe Gjykata e ka pranuar aplikimin. Në përfundim vendimi bëhet i ekzekutueshëm pas njohjes nga Gjykata Shqiptare e Apelit.

*Ndryshe nga vendimet e GJEDNJ, vendimet e Arbitrazhit Ndërkombëtar bëhen të zbatueshëm pas njohjes së vendimit nga Gjykata Shqiptare e Apelit. Për vendimet e zbatueshme Avokatura e Shtetit nuk disponon informacion lidhur me shumat e paguara nga institucionet respektive palë në gjykim, e si e tillë vlera e ekzekutuar dhe ajo për tu ekzekutuar nga buxheti i shtetit nuk mund të konfirmohet nga ky institucion, çka në vlerësimin tonë paraqet nevojën për një qasje ndryshe në dispozitat ligjore lidhur me këtë çështje.*

**1.1 Rekomandimi:** Kërkojmë edhe njëherë që, Avokatura e Shtetit të përfundoj krijimin e një database për të pasqyruar të gjitha të dhënat e çështjeve të filluara dhe të përfunduara, duke u angazhuar në zbatimin sa më parë të Urdhrit nr. 259 datë 01.07.2019 të Avokatit të Përgjithshëm të Shtetit.

*Menjëherë*

**1.2 Rekomandimi:** Avokatura e Shtetit të fillojë ndryshimet për plotësimin dhe përmirësimin e VKM nr. 392, datë 08.04.2009 për të parashikuar detyrimin e Avokaturës së Shtetit për regjistrimin e çështjeve të iniciuara për arbitrazh duke pasqyruar të dhënat mbi objektin e kërkesës, avokatit/studiove avokatore vendase/huaj të përzgjedhur për përfaqësimin e çështjeve në arbitrazh nga Avokati i Shtetit si dhe vendimin e arbitrazhit.

*Menjëherë*

**1.3 Rekomandimi:** Avokatura e Shtetit, të ndërmarrë nismat e nevojshme administrative e ligjore për pjesëmarrjen e detyrueshme të këtij institucioni në të gjithë proceset gjyqësore për njohjen e vendimeve të arbitrazhit ndërkombëtar nga gjykatat shqiptare, si dhe plotësimin e regjistrit elektronik dhe fizik të çështjeve gjyqësore me vlerat e ekzekutuara nga institucionet përkatëse të ngarkuara për zbatimin e tyre.

*Menjëherë*

## V- ANEKSE

*Aneksi I - “Vendime të fromës së prerë të dhënë nga Arbitrazhi Ndërkombëtar”*

*Aneksi II - “Çështje gjyqësore, në proces në Arbitrazhin Ndërkombëtar”*

*Aneksi III - “Qasja dhe metodologjia e auditimit”*

Për sa më sipër paraqitet ky Raport Përfundimtar Auditimi.

KONTROLLI I LARTË I SHTETIT



# KONTROLI I LARTË I SHITETIT

## Raport Përfundimtar për Auditimin e ushtruar në “AVOKATURËN E SHITETIT”

### ANEKSI I

#### VENDIMET E ARBITRAZHIT NDËRKOMBËTAR DERI MË 31.08.2019

Numri i Çështjes dhe viti i fillimit të arbitrazhit	Palët	Forumi i Arbitrazhit	Vlera e Dëmshpërblimit të kërkuar (€)	Statusi i Procesit të arbitrazhit	Viti dhe dispozitivi i vendimit (vetëm totali i principalit në €) në favor të Shqipërisë	Viti dhe dispozitivi i vendimit (vetëm totali i principalit në €) në disfavor të Shqipërisë	Komente mbi njohjen dhe ekzekutimin
ARB 11/18 2011	B.....SRL & E.... SHA kundër Republikës së Shqipërisë	ICSID - Qendra Ndërkombëtare për Zgjidhjen e Mosmarrëve shjeve të Investimit	9,970,000	Përfunduar në favor të Republikës së Shqipërisë duke u rrëzuar pretendimet e Paditësve dhe akorduar Shqipërisë rimbursim të kostove në vlerën \$442,081.3	Vendim/2013 442,081		Njohur në Gjykatën e Apelit dhe ASH i është drejtuar me urdhrin për ekzekutim Zyrës së Përmbartimit për ekzekutimin e vendimit.
UNCITRAL ARBITRATIO N 2011	S....P.....kundër METE/AKBN	UNCITRAL – Arbitrazh ad hoc	\$1,000,000,000,000	Përfunduar në favor të palës shqiptare. Tribunali ngarkoi Paditësin me pagesën e kostove të palës Shqiptare.	Vendim/2013 382,774		Është angazhuar një firmë avokatore e huaj për ekzekutimin e vendimit në USA nga ku rezultoi që Paditësi ishte i falimentuar.
ARB/11/24 2012	M..... kundër Republikës së Shqipërisë	ICSID - Qendra Ndërkombëtare për Zgjidhjen e Mosmarrëve shjeve të Investimit	46,000,000	Përfunduar dhe Tribunali ka rrëzuar pretendimet e Paditësit dhe e ka ngarkuar Shqipërinë me rimbursimin e kostove të Paditësit në vlerën prej \$149,759.14.		Vendim/2015 149,759	ASH nuk është njoftuar nga Gjykata e Apelit për ndonjë procedurë njohjeje dhe ekzekutimi të këtij vendimi
18474/GZ/M HM 2012	J.....kundër MPPT & ARRSH	ICC - Dhoma Ndërkombëtare e Tregtisë	25,000,000	Përfunduar në disfavor të palës Shqiptare, ku është vendosur detyrimi i kësaj të fundit për t'i paguar Paditësit €2,757,317.68		Vendim/2015 2,757,317	Paditësi ka kërkuar njohjen dhe ekzekutimin e tij në Gjykatën e Apelit e cila ka vendosur për njohjen e tij. Avokatura e Shtetit ka rekursuar vendimin e Gjykatës së Apelit.
UNC 137AGF 2013	T.....& S..... kundër KESH	UNCITRAL - Arbitrazh ad hoc	808,148	Përfunduar (në disfavor të KESH)		Vendim/2015 808,148	Paditësi ka kërkuar njohjen dhe ekzekutimin e vendimit para Gjykatës së Apelit, e cila ka vendosur rrëzimin e kërkesës. Vendimi i



## KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

### Raport Përfundimtar për Auditimin e ushtruar në “AVOKATURËN E SHTETIT”

							Gjykatës së Apelit është rekursuar nga Paditësi.
20564/EMT/GR 2014	H.....SRL Albania vs	ICC - Dhoma Ndërkombëtare e Tregtisë	147,872,749	Përfunduar në favor të Shqipërisë duke rrëzuar pretendimet e Paditësit dhe atribuar Shqipërisë vlerën e kundërpadisë me penalitetet përkatëse.	Vendim/2018 7,343,668		ASH nuk është njoftuar nga Gjykata e Apelit për ndonjë procedurë njohjeje dhe ekzekutimi të këtij vendimi
V2015/052 2015	C.....SH.P.K. kundër Zyrës Qendrore të Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme	SCC - Arbitrazi Ndërkombëtar i Dhomës së Tregtisë Stockholm - Suedi	1,381,640	Përfunduar (në disfavor të Zyrës Qendrore të Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme	Vendim/2016 1,076,556		Paditësi ka kërkuar njohjen dhe ekzekutimin e tij në Gjykatën e Apelit. Gjykata e Apelit ka vendosur njohjen dhe ekzekutimin e vendimit dhe Avokatura e Shtetit ka paraqitur rekurs në Gjykatën e Lartë.
21069/MHM 2015	V.....SH.P.K. kundër MPPT dhe APD	ICC - Dhoma Ndërkombëtare e Tregtisë	2,980,736	Përfunduar duke e detyruar palën Shqiptare t'i paguajë Paditësit 396,306.00	Vendim/2016 396,306		Paditësi ka kërkuar njohjen dhe ekzekutimin e tij në Gjykatën e Apelit e cila ka vendosur për njohjen e tij <u>pa qenë prezent Avokatura e Shtetit</u> . MIE bashkë me Avokaturën e Shtetit kanë kundërshtuar veprimet përbarimore (në proces).
ARB/17/6 2016	A.....vs Republic of Albania	ICSID - Qendra Ndërkombëtare për Zgjidhjen e Mosmarrëve shjeve të Investimit	224,070,235	Përfunduar në favor të Shqipërisë duke u rrëzuar pretendimet e Paditësit.	Vendim/2019		
	M.....kundër Avokaturës së Shtetit	Gjykata e Romës	15,000	Gjykata e Apelit ka vendosur rrëzimin e pretendimit të kërkuarit			Është ushtruar rekurs në Gjykatën e Lartë nga Kërkuari
<b>TOTALI</b>			<b>1,000,458,098,508</b>		<b>8,168,523</b>	<b>5,188,088</b>	



**KONTROLLI I LARTË I SHTETIT**  
**Raport Përfundimtar për Auditimin e ushtruar në**  
**“AVOKATURËN E SHTETIT”**

**ANEKSI II**

**CËSHTJET E ARBITRAZHIT NDËRKOMBËTAR NË PROCES DERI MË 31.08.2019**

Numri i Çështjes dhe viti i fillimit të arbitrazhit	Palët	Forumi i Arbitrazhit	Vlera e Dëmshpërblimit të kërkuar (€)	Statusi i Procesit të arbitrazhit	Viti dhe dispozitivi i vendimit (vetëm totali i principalit në €) në favor të Shqipërisë	Viti dhe dispozitivi i vendimit (vetëm totali i principalit në €) në disfavor të Shqipërisë	Komente
ARB/14/26	A.....SH.P.K., C..... SRL & A..... vs Republic of Albania	ICSID - Qendra Ndërkombëtare për Zgjidhjen e Mosmarrëveshjeve të Investimit	439,700,000	Në pritje të vendimit			
2014							
ARB/15/28	H.... SRL, C.... SRL, F...B....., M.... R....., S.....G.... L.... Co..... vs Albania	ICSID - Qendra Ndërkombëtare për Zgjidhjen e Mosmarrëveshjeve të Investimit	624,922,000	Përfunduar gjykimi i themelit të mosmarrëveshjeve të pretenduara (në disfavor të Shqipërisë). Shqipëria ka aplikuar për anulim të vendimit dhe Gjykata e ka pranuar aplikimin duke pezulluar përkohësisht ekzekutimin e vendimit.		Vendim/2019	Ekzekutimi i vendimit në Shqipëri bëhet duke kërkuar para Gjykatës së Apelit njohjen dhe ekzekutimin e vendimit. Këto hapa ndërmerren kur vendimi konsiderohet përfundimtar, ndërkohë që vendimi në fjalë nuk konsiderohet i tillë kur regjistrohet aplikimi për anulim.
2015						108,359,238	
21349/GR	B.....P.....vs MIE/AKBN & Albpetrol	ICC - Dhoma Ndërkombëtare e Tregtisë		Në proces			Paditësi ka kërkuar rimbursim të kostove hidrokarbure, në një vlerë për t'u përcaktuar më vonë, me naftë
2015							
600491-2017	E.....T...vs OSHEE	SCAI - Instituti i Arbitrazhit i Dhomës Zvicerane të Tregtisë	5,936,976	Në pritje të vendimit			
2017							



## KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

### Raport Përfundimtar për Auditimin e ushtruar në “AVOKATURËN E SHTETIT”

22676/GR	G.....LTD vs Ministry of Infrastructure, AKBN and Albpetrol	ICC - Dhoma Ndërkombëta re e Tregtisë	113,372,000	Në pritje të vendimit			
<b>2017</b>							
22919/GR	H..... SRL vs Ministry of Infrastructure & Energy	ICC - Dhoma Ndërkombëta re e Tregtisë	103,200,000	Përfunduar gjykimi në themel, në favor të Shqipërisë duke rrëzuar pretendimet e Paditësit dhe ngarkuar këtë të fundit me rimbursimin e kostove të Shqipërisë në vlerën €733,075	Vendim/2019		Vendimi konsiderohet jopërfundimtar, pasi Paditësi i ka kërkuar Tribunalit rishikim të Vendimit
<b>2017</b>					733,075		
2018-49	V.....SRL vs Albania	PCA - Gjykata e Përhershme e Arbitrazhit	4,800,655	Në proces			
<b>2018</b>							
23998/MHM (C- 24011/MHM)	Bashkimi i shoqërive "J.....& A.....", shoqëria "C....." dhe "A....." vs MIE/ARRSH	ICC - Dhoma Ndërkombëta re e Tregtisë	44,262,682	Në proces			
<b>2018</b>							
24140/MHM	C..... srl,"J ....." sh.p.k vs MIE/AKUK	ICC - Dhoma Ndërkombëta re e Tregtisë	20,000,000	Në proces			
<b>2019</b>							
<b>TOTALI</b>			<b>1,356,194,313</b>		<b>733,075</b>	<b>108,359,238</b>	



## KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

### Raport Përfundimtar për Auditimin e ushtruar në “AVOKATURËN E SHTETIT”

#### ANEKSI III QASJA DHE METODOLOGJIA E AUDITIMIT

##### **Materialiteti**

Përcaktimi i materialitetit sipas **sasisë** përfshin gjykimin mbi nivelin maksimal të pranueshëm të shmangies së përputhshmërisë me dispozitat ligjore, rregulloret. Ky materialiteti vlerësohet **deri në 2%** në nivel grupi dhe llogarie.

Një gabim/anomali është “material”, individualisht ose kur bashkohet me gabime/anomali të tjera, në qoftë se në mënyrë të arsyeshme mund të ndikojë në vendimet e marra nga drejtimi.

Në disa raste, gabimi edhe pse jo material nga ana sasiore, mund të shfaqet material për nga përmbajtja - duke ndikuar kështu në konkluzionet e auditimit. Çështjet që janë materiale nga natyra ose përmbajtja duhet të zbulohen; e megjithatë mbetet në gjykimin e KLSH-së, nëse për raste të veçanta këto parregullsi/gabime do të merren në konsideratë në raportin dhe opinionin e auditimit.

Përcaktimi i materialitetit nga **ana cilësore** “Një çështje ose grup çështjesh mund të jenë materiale ose për shkak të sasisë, natyrës (karakteristikave të brendshme) ose nëvarësi të kontekstit të tyre” të cilat do të lidhen me përputhshmërinë e veprimtarisë së institucionit vlerësohen materiale nga ana cilësore për vet impaktin real por dhe ndjeshmërinë publike të cilin ka veprimtaria e Avokatura e Shtetit.

##### **Vlerësimi i riskut të auditimit**

Të kuptuarit e strukturës së kontrollit të brendshëm të njësisë që auditohet, përcaktimi i drejtimeve kryesore të auditimit, Vlerësimin e përgjithshëm mbi ekzistencën dhe funksionimin e kontrollit të brendshëm me qëllim përcaktimin e nivelit të përgjithshëm të riskut të njësisë që auditohet.

##### **Fazat:**

Njohja e aktivitetit të subjektit me qëllim identifikimin dhe vlerësimin e riskut të brendshëm.

Vlerësimi i sistemeve të Kontrollit të Brendshëm

Përcaktimi i Riskut të Zbulimit, është risku që audituesi nuk do të arrijë të zbulojë një shmangie, e cila nuk është korrigjuar nga vetë sistemet e kontrollit të brendshëm të subjektit.

KLSH aplikon Modelin e Sigurisë, që tregon se niveli i besueshmërisë rrjedh nga dy burime kryesore që janë: sistemet e kontrollit dhe testet thelbësore.

Si pikënisje shërben risku i brendshëm

##### **Risku i brendshëm (jo i lartë = 0.6 dhe i lartë = 1.0)**

Gjykohet dhe vlerësohet që në fazën e planifikimit dhe ushtrimit të auditimit të përputhshmërisë, se mund të kemi elementë materialë për vlerësimin e një risku të brendshëm, që lidhet me një nivel të mundshëm të shmangieve për sa i takon përputhshmërisë me ligjet dhe rregulloret në fuqi. Gjykohet se ka elementë të **riskut të brendshëm**, që lidhen me procesin e vendimmarrjes, organizimin dhe funksionimin, kuadrin





## KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

### Raport Përfundimtar për Auditimin e ushtruar në “AVOKATURËN E SHTETIT”

rregullator mbi të cilin ushtrohet veprimtaria por dhe madhësisë së saj risku i brendshëm paraprakisht vlerësohet *Jo i Lartë*.

**Risku i Kontrollit të brendshëm** (I ulët = 0.15, I mesëm = 0.25, dhe I lartë = 1.0)

Bazuar në të dhënat paraprake kontrolli i brendshëm ekziston dhe ka të ngjarë të funksionojë në mënyrë efektive dhe të vazhdueshme gjatë periudhës nën auditim. Por bazuar në kompleksitetin e operacioneve të subjektit dhe natyrën e kompleksitetin e sistemeve të kontrollit të brendshëm, risku që një anomali materiale mund të ndodhë dhe mund mos të parandalohet ose zbulohet dhe korrigohet në kohë nga sistemet e kontrollit të brendshëm paraprakisht vlerësohet në nivelin *I Mesëm*.

#### Risikut i zbulimit

Duke qenë se KLSH konsideron *Riskun e Auditimit* në masën 5% duke konsideruar një siguri auditimi prej 95% , *Risku i zbulimit* i përcaktuar mbi modelin e sigurisë vlerësohet si vijon:

Nr.	Zonat e auditimit të marra në shqyrtim	Rrisku i brendshëm (IR) (0,6 deri ne 1)		Rrisku i kontrollit të brendshëm (CR) (0,15 - 0,25 - 1)			Risku i zbulimit (DR)		Niveli i besueshmerise (1-DR) (1-DR) Ne perqindje	Niveli i testeve thelbësore për t'u kryer
		I Ulët	I Lartë	I Ulët	I Mesëm	I Lartë	DR = AR/ (IR x CR)	DR ne (%)		
1	<i>"Ecurinë e detyrimeve shtetërore për Vendime të formës së prerë të GJEDNJ dhe Arbitrazhit Ndërkombëtar si dhe vlerat e ekspozimit të Buxhetit të Shtetit nga çështjet në proces gjykimi.</i>	0.80			0.25		0.25	25%	75%	I fokusuar

Bazuar në informacionin paraprak metodologjia e auditimit vlerësohet të bazohet në përzgjedhjen me bazë risku, duke marrë në konsideratë ato kontrole që janë përkatës për objektivat e auditimit, ku rëndësi i jepet edhe gjykimit profesional të audituesit nëse një kontroll i veçuar ose në kombinim me të tjerë, është i përshtatshëm.

Metodologjia e aplikuar gjatë planifikimit konsiston në auditimin e të dhënave të siguruar nga vetë subjekti si dhe dokumentacionin shoqërues dhe verifikimin e tyre. Konkretisht, mbi të dhënat e disponuara u aplikuan:

- teste të kontrolleve për të verifikuar se si kanë funksionuar sistemet e kontrollit të brendshëm; dhe
- teste të detajeve.